



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË**

**Data 16.02.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Karburant dhe vaj (blerje Gaz i Lengshem)**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Gaz i lëngshëm propan 09122110-4

Gaz i lëngshëm butan 09122210-5

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**6.911.613 ( gjashtë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë)lek,pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres te parashikuar te kontrates.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

**Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.**

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.**

---

**2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

---

**Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

**Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

---

2.2.2 Ofertuesi duhet të jetë i licensuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

Për sa me sipër duhet të paraqesë Licence për tregëtimin me pakice të gazit të lengshëm lëshuar nga organet e pushtetit vendor.

**Argumentimi: “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 “Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e nënprodukteve të tyre” të**

*ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

---

**2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Ofertuesi të disponojë një autobot në pronësi ose me qera për të cilin duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të tij, Siguracionin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

Në rast se është marrë me qera të paraqesë kontratën e qera-marrjes, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të qiradhenesit, siguracionin e mjetit, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkua më sipër do të kërkohen operatorit i kualifikuar i pari, para se të publikohet njoftimi i fituesit paraprak ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Kriteri i mesipërme u vendos duke patur parasysh përcaktimin e bërë në specifikimet teknike që: gazi do të levrohet me autobot në kaldajën respektive.*

*Per sa me sipër është e nevojshme vendosja e kriterit për disponimin e një autoboti i cili duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim në mënyrë që të realizohet me sukses furnizimi i kaldajës me gaz.*

---

## **2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.1 Raport analize të cilësive të gazit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes së tenderit.

2.3.2 Deklarate në bazë të së cilës ofertuesi merr përsipër furnizimin me gaz sipas standardeve në fuqi.

2.3.3 Deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me gaz me autobotin e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.

**Argumentimi :** *Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6.c dhe pika 8, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Kriteri i mesiperm u vendos me qellim qe te vertetohet se gazi qe operatori tregeton eshte konform standarteve ne fuqi.*

---

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Specifikimet teknike, kriteret e vecanta te kualifikimit llogaritja e sasise dhe fondit limit, jane hartuar dhe derguar nga Qendra Sportive Korçë sh.a , me shkrese Nr 7 Prot date 17.01.2023 protokolluar me Nr 200/2 date 18.01.2023 .**

**NJËSIA E PROKURIMIT**